



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. _____ Prot.

Data __. __. 2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: : “Blerje materiale pastrimi për Institucionet Arsimore,
Bashkia Berat”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT FPP) 18424000-7
dorashka / 24311900-6 klor / 33141610-9 qese mbledhese/ 33711900-6 sapun / 3922400-8 fshesa, furca
dhe artikuj te ndryshem, /39224330-0 kova/ 39224340-3 kosha mbeturinash/ 39831200-8 detergjente/
39831300-9 pastrues dyshemeje, 39831210-1 detergjente per ene**

**VLERA E FONDIT LIMIT: : 2 364,874 (dymilion e treqind e gjashtedhjetë e katër mijë e teteqind
e shtatedhjetë e katër) lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe
nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit
publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Arsimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin
dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar,
me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E ARSIMIT

2.2.1. **Xhiroja vjetore minimale** -Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së Fondit Limit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 3 vitet e fundit financiare Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të VKM nr.285, date 19.05.2021, neni 43, pika 4 (shëno bazën ligjore), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. **Dëshmi për furnizime të ngjashme të mëparshme** në një vlerë jo më të vogël **20%** të vlerës së fondit limit, për të cilin konkuron operatori ekonomik, që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës si më poshtë :

- a) Autoriteti Kontraktor si dëshmi për përvojën e më parshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, kontrata furnizimi dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumatat, sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumatat sasi të mallrave të furnizuara

2.3.2 Operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë dhe paraqesin çertifikatën sipas standarteve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht :

ISO 9001:2015 (Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent e njohur nga DPA.

ISO 14001:2015 (Çertifikatë për Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit) ose ekuivalent e njohur nga DPA.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E ARSIMIT

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.3 Dekalrate nga operatori ekonomik për përmbushjen e specifikimeve teknike.

Ofertuesi i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit së bashku me dokumentacionin provues duhet të paraqesin nga një mostër për produktet e kërkuara si më poshtë:

- Aparat+aromatizues,
 - Detergjent enesh,
 - Detergjent lavatrice,
 - fshesa plastike,
 - Kosha mbeturinash 18 litra,
 - Kova+shtrydhese, 13litra,
 - Sapun I lengshem,
 - Solucion xhamash,
 - Solucion pastrim dysHEMEJE arome,
 - Acid,
 - Solucion dezinfektues,
 - Tel enesh për t’i krahasuar ato me specifikimet teknike dhe specifikisht për produktet e pastrimit
- Mosparaqitja e mostrave është kusht skualifikimi

Materialet e Pastrimit të jenë cilësore sipas preventivit dhe specifikimeve teknike të mallrave , Afati i skadences: (për mallrat të cilat kanë skadencë) data e skadences në ditën e levrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se $\frac{1}{2}$ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadences.

Ky kriter është kriter që rrit sigurinë tek Autoriteti Kontraktor që mallrat janë cilësor dhe kanë afat përdorimi.

Te gjitha produktet të kenë skadencën mbi një vit. Te dhenat e secilit produkt të jenë të shënuar në ambalazh dhe të jenë prodhim CE.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E ARSIMIT

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë percaktuar nga specialistja e higjenes ne drejtorine e arsimit Bashkia Berat

fondi limit eshte percaktuar nga komisioni i ngritur me urdhrin e drejtorit

Specifikimet teknike të mallrave Objekt prokurimi janë hartuar duke u bazuar në nevojat reale të përdorimit të mallrave Objekt të prokurimit. Produktet e kërkuara janë të rëndësishme në ushtrimin e detyrave funksionale të autoritetit kontraktor. Këto produkte garantojnë marrjen e masave efikase për krijimi e kushteve optimale të higjenes në objektet publike dhe arsimore sipas detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Karakteristikat teknike dhe përbërësit kimikë të produkteve janë kërkuar në përputhje me kriteret e përcaktuara në bazën ligjore në fuqi për detergjentët dhe produktet jo-ushqimorë. Standartet teknike të kërkuara janë konsultuar me bazën ligjore në fuqi ku është verifikuar përcaktimi teknik për çdo element në veçanti. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT

MIRATOHET



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E ARSIMIT

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
KLODIANA HOXHA